

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Mejreme Memaj, kryetare, Driton Muharremi dhe Have Haliti, anëtar, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, si procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarave M.SH. nga Gjilani dhe H.Z. nga Vitia për shkak të veprës penale trajtim i pandërgjegjshëm mjekësor nga neni 260 par.4 e lidhur me par.1 të KPRK-së, dhe V.K. nga Gjilani për shkak të veprës penale mosdhënia e ndihmës mjekësore nga neni 261 par.1 e lidhur me par.3 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, PKR.nr.114/16 datë 31.05.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me 27.09.2017 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, PKR.nr.114/17 datë 31.05.2017, **vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Gjilan me aktgjykimin PKR.nr.114/17 datë 31.05.2017, të akuzuarat M.SH. dhe H.Z., i ka liruar nga akuza konform nenit 364 par.1 pika.1.3 dhe nenit 454 par.1 e 463 par.3 të KPRK-së, për shkak të veprës penale trajtim i pandërgjegjshëm mjekësor nga neni 260 par.4 e lidhur me par.1 të KPRK-së, dhe të akuzuarën V.K. gjithashtu e ka liruar nga akuza për shkak të veprës penale mosdhënia e ndihmës mjekësore nga neni 261 par.1 e lidhur me par.3 të KPRK-së. Shpenzimet e procedurës, mbesin në barrë të mjeteve buxhetore të Këshillit Gjyqësorë të Kosovës. I dëmtuari A.S., për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike udhëzohet në kontest civil.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur:

- Prokuroria Themelore në Gjilan për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke propozuar që Gjykata e Apelit ta aprovoj ankesën dhe aktgjykimin e Gjykatës Themelore për arsyet e lartpërmendura ta anuloj në tërësi si të pabazuar dhe jo ligjor dhe shkresat e kësaj lënde t'ia kthej gjykatës se shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje që të vlerësoj drejt provat apo të njëjtin aktgjykim ta ndryshoj dhe të akuzuarat ti shpallë fajtor për veprat penale për të cilat janë akuzuar dhe ti dënoj me dënim meritator sipas ligjit.

Përgjigje në ankesën e Prokurorisë kanë parashtruar mbrojtësi i të akuzuarës M.SH. av. F.L., e akuzuara V.K. dhe mbrojtësi i të akuzuarës V.K. av. SH.P., duke propozuar që ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan të refuzohet si e pa bazuar dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të vërtetohet.

Prokurori i Apelit, me parashtrësën me shkrim PPA./I.nr.313/17 datë 03.07.2017, ka propozuar që ankesa e Prokurorit Themelor në Gjilan të aprovohet si e bazuar, kurse

përgjigjet në ankesën e prokurorit të PTH të parashtruara nga mbrojtësit e të akuzuarave të refuzohen si të pabazuara, meqë nuk qëndrojnë pretendimet e cekura si në këto ankesa.

Gjykata e Apelit shqyrtoi shkresat e kësaj lënde, studioi aktgjykimin e kundërshtuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP dhe pas vlerësimit të pretendimeve ankimore konstatoi:

-ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan nuk është e bazuar.

Prokuroria në ankesë thekson se aktgjykimi i shkallës së parë është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 pika 1.12 të KPP, pasi që dispozitivi është tërësisht i pa kuptueshëm dhe kundërthënës në brendinë e saj e sidomos faktin kur arsyet janë të paqarta, ka kundërthënë në mes tyre sidomos në mes të asaj që paraqitet në arsyetim lidhur me përmbajtjen e shkresave dhe procesverbaleve për deklarimet e dhëna të dëshmitarëve e sidomos të ekspertit mjeko-ligjor A.G. dhe Dr. A.E. që argumentojnë shkaqet e vdekjes së pacientes si dhe deklaratës së dëshmitares B.F., P.S. dhe Z.S. që argumentojnë mosdhënien e ndihmës dhe gjendjen e rëndë shëndetësore të bebes, nga përmbajtja e shkresave, procesverbaleve dhe provave të cilat i janë ofruar gjykatës për ta provuar bazën e akuzës sonë e që tregojnë se gjykata nuk ka pasur të drejtë që të akuzuarit të i liroj nga akuza pasi që me asnjë provë nuk është vërtetë e kundërta. Askund nuk është theksuar se dëshmitarja V.K. ka deklaruar se shkak i vdekjes së pacientes ka qenë lëngu amnial e që konstatohet nga gjykata në faqen 47 pasusi i 5. Shkelja tjetër esenciale ka të bëjë me arsyetimin e aktgjykimit në faqen 52 pasusi i fundit ku kryetari i trupit gjykues parashtron pyetje të cilat nuk dihen se për kënd janë dhe atë se “cilat kanë qenë medikamentet që nuk ia ka dhënë, e a ka qenë e obliguar me ja dhënë pacientes e akuzuara V.K.” e pikërisht për këtë është akuzuar e njëjta që nuk i ka ofruar ndihmë mjekësore dhe ka refuzuar dhënien e ndihmës mjekësore për ta kontrolluar pacienten dhe për të përcaktua se çfarë medikamentesh është dashur ti jepen për të mos ardhur deri te vdekja e saj. Shkelja tjetër ka të bëjë me atë se gjykata dëshmitarëve të dëshmitarëve A.M., K.S., Z.A., R.R., L.R., B.K. dhe A.A. i ka konsideruar si të pa rëndësishme për të vërtetuar gjendjen faktike e që sipas prokurorisë të njëjtat vërtetojnë gjendjen faktike për kryerjen e veprës penale nga të tri të akuzuarat. Arsyetimi i aktgjykimit është kontradiktor dhe në kundërshtim me dispozitivin e aktgjykimit pasi që po të lexohet arsyetimi nënkupton se kemi të bëjmë me një aktgjykim dënues ndërsa gjykata me këtë arsyetim ka arsyetuar aktgjykimin lirues e që është i paqartë dhe në kundërshtim me vetveten. Edhe pse gjykata nuk ka vlerësuar deklaratat e dëshmitarëve të cekur më lartë, këta dëshmitar vërtetojnë gjendjen faktike e në veçanti deklarata e dëshmitares Z.A. e cila ka deklarua “beba para aktit të lindjes, gjatë aktit të lindjes dhe pas ka qenë në gjendje shëndetësore” dhe se me këto prova vërtetohet se pacientja ka pasur paraprakisht nevojë për dhënien e ndihmës mjekësore dhe se të njëjtës nuk i është ofruar kjo ndihmë. Për shkak të shkeljes së Ligjit Penal gjykata i ka zbatuar dispozitat ligjore për lirim të akuzuarave nga akuza të cilat dispozita nuk mund të zbatohen sepse veprimet e të akuzuarave gjithsesi kanë paraqitur figurën e veprave penale për të cilat janë akuzuar.

Gjykata e Apelit e Kosovës me vëmendje e ka shqyrtuar ankesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan dhe shkresat e lëndës dhe vlerësoi se ankesa është e pa bazuar. Aktgjykimi është i qartë dhe konkret, gjykata ka dhënë arsyet për faktet vendimtare, ka arsyetuar provat dhe në rastin konkret drejtë ka vepruar kur ka konsideruar se në veprimet e të akuzuarave nuk qëndrojnë elementet e veprave penale për të cilat ato janë akuzuar. Gjykata ka arsyetuar secilën provë veç e veç, të njëjtat i ka ndërlidhur në mes veti duke arsyetuar faktin se përse disa provave ua ka fal besimin e disave jo, si dhe arsyeve në të cilat është bazuar me rastin e zgjidhjes së kësaj çështjeje penalo-juridike. Siç del nga shkresat e lëndës dhe nga aktgjykimi i atakuar nga ana e prokurorisë shihet se gjykata ka administruar provat materiale dhe jo materiale duke dëgjuar të dëmtuarin A.S., dëshmitaren A.M., K.S.,

H.R., T.D., V.TH., U.I., Z.A.,A.E., N.SH., B.F., M.R., R.R., F.G., P.S.-SH., XH.Z., L.R., T.H., B.K., L.SH., G.A., M.XH., A.F., A.A., M.R., ka administruar edhe provat materiale siç është raporti i autopsisë i kryer nga Dr. A.G. i cili edhe është dëgjuar në cilësi të ekspertit, raporti i ekzaminimit patologjik i kryer nga Dr. V.K. e cila edhe është dëgjuar në shqyrtimin gjyqësor, super ekspertiza e kryer nga ekspertët Dr. B.C.-specialiste e mjekësisë ligjore, Dr. S.L.- patologe, Dr. I.K. – anesteziolog dhe Dr. F.A. gjinekolog, është dëgjuar në seancën gjyqësore kryetarja e komisionit Dr. B.C., raporti i oficerit nr. 0242016, raporti i lëshuar nga Spitali Regjional në Gjilan i dt. 03.03.2016 si dhe anamneza e po të njëjtës datë, historia e sëmundjes me numër 332/16 e datës 02.03.2016, analizat mikrobiologjike me numër 13620 e dt. 20.10.2015, raporti i spitalit regjional në Gjilan i dt. 02.03.2016, raporti i lindjes nr. 303/16 i dt. 03.03.2016, raporti mjekësor për vdekjen i të njëjtës datë, kopja e SMS-ve në mes të ndjerës A.S. dhe P.S., është shikuar foto dokumentacioni dhe janë dëgjuar mbrojtjet e të akuzuarave, dhe pas analizimit të tyre gjykata ka ardhë në konkludim me të drejtë se nuk është provuar se të akuzuarat kanë kryer veprën penale për të cilat janë akuzuar. Kjo për faktin se për tu konsideruar veprimi i një personi si trajtim i pa ndërgjegjshëm mjekësor dispozita ligjore e parasheh që mjeku me rastin e dhënies së ndihmës mjekësore ka përdorur haptazi një mjet apo metodë të pa përshtatshme të mjekimit ose nuk i përdor masat përkatëse higjienike dhe me këtë shkakton keqësimin e gjendjes shëndetësore të personit. Në rastin konkret kjo u vërtetua edhe me ekspertizën e Dr. A.G. pavarësisht kontradiktave në përcaktimin e diagnozës apo arsyeve të vdekjes pasi që vetë Dr. G. në ekspertizën e tij ka theksuar se tani e ndjera A.S. është trajtuar në bazë të standardeve mjekësore dhe se nuk ka standard tjetër mjekësor që është dashur të zbatohet e nuk është zbatuar ndërsa ekspertiza e Dr. V.K.t përcakton një konstatim i cili përputhet edhe me super ekspertizën e urdhëruar nga ana e gjykatës e ku sipas ekspertes Kotori është konstatuar se në mushkëritë e pacientes A.S. shihen përmbajtje granulare, eozinofilike, detritus dhe numër i shtuar i inflatrive leokocitare që mund ti përgjigjen përbërësve të lëngut amnial e që sipas sajë arsyeja ka të bëjë me faktin se shkak i vdekjes së pacientes është lëngu amnial e që përputhet edhe me super ekspertizën e urdhëruar nga gjykata nga katër ekspert e të cilët në konkluzionin e tyre kanë theksuar se shkak i vdekjes së të ndjerës A. dyshohet të ketë qenë embolia e lëngut amniotik, se nuk janë gjetur shkelje të protokolleve klinike të trajtimit dhe se nuk janë gjetur ndryshime makroskopike dhe mikroskopike që flasin për atoni të mitrës. Ndërsa për diagnozë definitive është rekomanduar të bëhen ngjyrimet speciale në ndonjë institucion jashtë vendit pasi kjo nuk bëhet në Kosovë por që duke pas parasysh provat e cekura më lartë kjo gjykatë konsideron se një veprim i tillë është i pa nevojshëm pasi që ka prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë të kundërtën e asaj të cilën pretendon prokuroria. Edhe ekspertja B.C. në cilësinë e kryetares së komisionit të super ekspertizës në shqyrtimin gjyqësor ndër të tjera ka theksuar se janë ndërmarrë veprimet e duhura sipas standardeve pas lindjes së pacientes ndërsa çështja e lëngut amnial është problem botëror, diagnoza nuk është e mundur të jetë ditur nga ana e të akuzuarave pasi kjo klinikisht nuk mund të diagnostikohet në shumicën e rasteve. Ka theksuar se lëngun amnial e kanë konstatuar në bazë të ngjyrimit të thjeshtë, kanë par elementet që janë të dyshuara të lëngut amnial që i kanë bërë për me kërkua ngjyrim special për konfirmimin e diagnozës. Kanë qenë edhe dy elemente tjera që janë në dukje ndryshimet e përgjithshme, por në këtë rast i ka mbështetur akoma më shumë teorinë e embolis së lëngut amnial dhe këto ndryshime janë kongjestionin kapilar që nënkupton bllokimin e gjakut nëpër enët e imëta mushkërore dhe edema pulmonare që është rezultat i kongjestionit kapilar kur pjesa e lëngshme e gjakut del prej enës së gjakut dhe kalon në indin përreth e që në këtë situatë gjakderdhja masive nga mitra nuk është normale, që gjaku dikund me rrjedh e dikund me u blloku. Se është e pamundur saktësisht të konstatohet se si është futur lëngu amnial në qarkullimin e gjakut të pacientes sepse nuk mund të dihet se në cilën fazë të lindjes mund të futet në qarkullim të gjakut dhe se në 70% të rasteve depërton gjatë procesit të lindjes. Ka përshkruar shenjat e para të embolis si vështirësi në frymëmarrje, nxirja e buzëve dhe mollëzave të gishtave, fillon të bie tensioni dhe në shumicën e rasteve manifestohet me çrregullim të vetëdijes dhe me gërrqe dhe se është 80% e bindur se shkak i

vdekjes së pacientes është embolia e lëngut amnial që sipas saj këtë e kanë mbështetur edhe anëtarët tjerë të komisionit. Lëngu i embolisë amniale sipas ekspertës është vështirë i përcaktueshëm klinikisht dhe gati e pamundur të parandalohet. Nga gjitha këto që u cekën më lartë u vërtetua se pacientja –tani e ndjera është trajtuar sipas standardeve mjeksore dhe konform rregullave mjekësore. Pra përveç se pacientja është trajtuar sipas standardeve mjeksore edhe shkaku i vdekjes vërtetohet se ka qenë depërtimi i lëngut amnial në qarkullimin e gjakut e jo ashtu siç pretendon prokuroria se shkak i vdekjes ka qenë pasoja e humbjes së sasisë së mjaftueshme të gjakut. Sa i përket faktit se nuk ka pasur mjek gjinekolog prezent por vetëm mamia gjegjësisht motra B. ku e njëjta ka deklaruar se shefja e sallës Maxhide dhe mjekja kujdestare kanë qenë të zëna me paciente të tjera te ultrazëri e njëjta ka deklaruar se te lindjet normale dhe me stimulues këto lindje udhëhiqen nga mamia ndërsa te lindjet e komplikuar i thërrasin mjekët dhe se në rastin konkret kjo lindje nuk ka qenë e komplikuar e çka vërtetohet edhe nga dëshmitarja H.R. – mjeke gjinekologe. Ndërsa sa i përket të akuzuarës V.K. e cila është akuzuar për mosdhënieje të ndihmës mjekësore nga neni 261 par.1 dhe par 3 të KPRK edhe në këtë rast gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka konstatuar se nuk është provuar se në veprimet e saj kanë qëndruar të gjitha elementet e kësaj vepre për të cilën është akuzuar nga prokuroria. Kjo pasi nga shkresat e lëndës, vërtetohet se e akuzuara Vjollca, më dt. 02.03.2016, ka qenë në kujdestari në repartin e gjinekologjisë, dhe se të nesërmen më dt. 03.03.2016, në ora 7:00 min. ia ka dorëzuar kujdestarinë të akuzuarës H.Z.. E akuzuara V., e ka bërë pranimin, e ka kontrolluar gjatë natës dhe se nuk ka vërejtur tek e ndjera A., diçka të jashtëzakonshme dhe se gjendja shëndetësore ka qenë normale, e kjo u vërtetua edhe nga dëshmitë e dëshmitareve H.R., T.D. dhe V.TH., N.SH. dhe të dëshmitareve motra-mami, B.F., M.R., XH.Z., T.H. dhe M.R., të cilët kanë marrë pjesë në praninë dorëzimin e kujdestarisë nga ana e të akuzuarës Vjollca tek e akuzuara H., ku nuk është paraqitur ndonjë shqetësim lidhur me këtë paciente, e që edhe në vizitën mjekësore të mëngjesit nuk kanë vërejtur diçka të jashtëzakonshëm tek pacientja. Edhe kjo gjykatë pajtohet me konstatimin e gjykatës së shkallës së parë, se SMS të cilën e ndjera ia ka dërguar P.S.t, nuk është provë nga e cila mund të provohet se e ndjera ka kërkuar ndihmë nga stafi mjekësor e që nuk i është dhënë por vetëm se ka dhimbje dhe duhet me e pritë vizitën. Edhe sa i përket dëshmisë së dëshmitares Bedrije e cila është përkujdesur gjatë lindjes për A., e që ka të bëjë me ate se është thirrur doktoresha Vjollcë, e ajo i ka thënë thirre doktoreshën H.e pasi kjo e ka përfundua orarin e kujdestarisë e se kjo e kishte thirrur dhe ajo kishte ardhur te pacientja menjëherë e qe ardhja e dr.H.es menjëherë është vërtetu me deklaratën e dëshmitares L.SH., motër-praktikante ku nder të tera ka thënë se deri sa kjo e ka kërkuar dr.H.en e njëjta veç kishte mbërri ne sallë po ashtu nuk është vërtetuar nga ana e prokurorisë se cilat kanë qenë ato medikamente qe nuk i janë dhënë pacientes nga ana e te akuzuarës Vjollca e qe ka qenë e obliguar e akuzuara dhe se me çka u vërtetua se e njëjta pacientes para aktit te lindjes ka refuzuar ti ofrojë ndihmë mjekësore kur edhe nga eksperti mjeko –ligjor e po ashtu edhe nga super ekspertiza është vërtetuar se pacientja A.S. është trajtuar sipas standardeve mjekësore.

Duke pasur parasysh se aktgjykimi i shkallës së parë nuk është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale si dhe gjendja faktike është vërtetuar drejtë nuk kemi as shkelje të ligjit penal e që do ta kushtëzonte anulimin e aktgjykimit.

Nga sa u tha më lartë, e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Procesmbajtësja,
Bujar Balaj _____

Kryetarja e kolegjit – gjyqtarja,
1. Mejreme Memaj _____

Anëtarët e kolegjit:

2. Driton Muharremi _____

3. Have Haliti _____